

S T A T U T I
I SHOQËRISË TREGTARE
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ARBËR CONSTRUCTION” SH.P.K.

Sot, më datë 02.07.2024, unë Ortaku i shoqërisë “ARBËR CONSTRUCTION” SH.P.K. Qemal KAROSHI, bazuar në vullnetin tim të lirë themelova shoqërinë “ARBËR CONSTRUCTION”, i ndryshuar, dhe vendosa të hartoj këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “ARBËR CONSTRUCTION” SH.P.K.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot më 02.07.2024, unë themeluesi, krijova shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin:
“ARBËR CONSTRUCTION” SH.P.K.

Themeluesi i shoqërisë është:

Z.Qemal KAROSHI, atësia: Nevrus, i datëlindjes 08.12.1982, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me numër: 036540146 dhe Numër Personal: I21208141I, lindur në Mustafe, Dibër dhe banues në Durrës, Rruga “Danish Bebeziqi”, Nd.8; H.1, Kutia postare 2003.

Neni 2

Selia

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Durrës, Lagjia 8, Rruga:“Danish Bebeziqi”, Zona Kadastrale 8512, Pasuria Nr.1/386, Nd.8; H.1; Kati I; Kutia postare 2003.

Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papërcaktuar.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile, industriale, banesa, hotele, objekte kulti, rrugë, infrastrukturë, etj. Punime të përgjithshme në ndërtim, si: punime strukturore, hekuri, betoni dhe armature, muratura, suvatime, nivelime, shtrim pllakash, instalime elektrike, hidroizolime dhe hidraulike, si dhe punime të tjera në ndërtim.

Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, punime nëntokësore, ura e vepra arti, diga dhe tunele hidroteknike, ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime, punime të inxhinierise së mjedisit, rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, etj.

Tregti të artikuj të ndryshëm, materiale ndërtimi, lëndë të para dhe të tjera produkte të ngjashëm, etj. Shërbime transporti për materiale, mallra dhe udhëtarë.

Shoqëria mund të kryejë cdo operacion tregtar, si edhe të blejë dhe të shesë ose të marrë me qera ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, të themeluara apo ne themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm më të vetin, apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali fillestar i shoqërisë është 800 000 (tetëqindmijë)lekë.

Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij.

Ortaku themelues është:

Z.Qemal KAROSHI, zotërues i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 800 000(tetëqindmijë)lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve përderisa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asambelë të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asambelë të përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë të përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet me shkrese ose mesazh elektronik, duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithe ortakëve jo me vone se para 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur, asambleja e pergjithshme e ortakëve nuk eshte thirrur sipas kesaj menyre, ajo mund te marre njoftime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme e ortakëve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 20 % te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 Te Ligjit “Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit 88 te ligjit sipermendur.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite

Neni 11

Marrja e Vendimeve

Asambleja e pergjithshme e Ortakëve, vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakëve pjesemarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e pergjithshme e ortakëve vendos me shumicen e votave te ortakëve pjesemarres, per ceshtje te tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përrjashtimi nga e drejta e votës

Ortakut nuk mund të ushtroje të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhenien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortakut përfaqësohet nga një i përfaqësuar i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu siç është dhe ortakut, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Administratori i shoqërisë emërohet:

Z.Qemal KAROSHI, atësia: Nevrus, i datëlindjes 08.12.1982, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me numër: 036540146 dhe Numër Personal: I21208141I, lindur në Mustafë, Dibër dhe banues në Durrës, Rruga "Danish Bebeziqi", Nd.8; H.1, Kutia postare 2003.

Z.Qemal KAROSHI, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) të kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f) të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) të kryejnë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin e shoqerise ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15 **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

KREU IV

VITI FINANCIAR- EKSPERTËT

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i parë financiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton Llogaritë vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijimin e fondit rezerve, fondeve për investime, si dhe destinime të tjera të fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

Neni 17 Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tilla. i ngarkuar nga ana e ortakeve

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

KREU V

PRISHJA – RIORGANIZMI I SHOQËRISË

Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo

person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë: Bashkimi - Ndarja

Shoqëria mund të ndahet , bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve , në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2012 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ARBËR CONSTRUCTION” SH.P.K.

Qemal KAROSHI